



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

NEON PRIMOLAC PROFFESIONAL (ASTAR PROFESIONAL PER METALE)

Skedë Teknike

PËRSHKRIMI: NEON PRIMOLAC PROFFESIONAL është një astar i cili përdoret si dorë e parë, përpara se të përdorim bojrat zmalto të tjera, PRIMOLAC përdoret kryesisht për të mbrojtur konstruksionin metalik nga korrozioni si edhe për të përmirësuar ngjitjen e bojës me konstruksionin. Ai mbush defektet apo gropat që mund të ketë sipërfaqja që do të bojatiset. Pastrohet lehtësisht. Referuar përbërësve të saj, ka vetinë që të frenojë procesin e oksidimit (ndryshkjes) të sipërfaqeve metalike, në mjedise të brendëshme dhe të jashtme.

FUSHA E PËRDORIMIT: NEON PRIMOLAC PROFFESIONAL përdoret për dorën e parë të lysterjes së sipërfaqeve metalike, në mjedise të brendëshme dhe të jashtme, për mbrojtjen nga ndryshku të këtyre sipërfaqeve, si edhe shërben si mbushës i hapsirave që mund të ketë konstruksioni metalik.

NGJYRA: Transparente

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës apo të ndryshkut, të lidhura dobët me sipërfaqet.

PËRDORIMI: Përzijeni mire përpara përdorimit, mund të lyhet me rrul, furcë ose pistoletë. Temperature gjatë aplikimit nuk duhet të jetë nën 5°C.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i primer-it në sipërfaqe të njoma dhe dhe të pa pastruara paraprakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjeksore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lysterjes paisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....Transparent
- Imtësia.....5 – 25 µm
- Mbetja e thatë.....35 %
- Densiteti.....0.94 – 1.1 g/ml
- Fuqia mbuluese për lysterje të plotë.....10 – 12 m²/L
- Koha e tharjes.....2 – 3 orë

REZIKSHMËRIA: Astore PRIMOLAC janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten (R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), në vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu, mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vënde të sigurta (S 35).

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75L.